



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-31227/2025
Kaçanik, 30.12.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e 8), mbajtur me 30.12.2025. Mbledhja është mbajtur në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 20 anëtarë, në ndërkohë arriti edhe anëtari Betim Shala, kështu që përbërja e KK, konstatohet së është 21 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive komunale në detyrë: Qamil Stagova-DUKMM Valdrin Dogani-DBF, Arian Teneqja-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin, Bejtulla Dalloshi, Makfire Malsiu.

Nga OSBE- mbledhjen e monitoroj Faruk Dërmaku, ndërkaq nga strukturat vendore mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari i MAPL, Nehat Uka.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtëse, Makfire Malsiu, ZLPKK.

Kryesuesi i Kuvendit z. Selajdin Troni: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, prezent janë 20 anëtarë, për momentin nuk është Betim Shala. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e I-r të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2025 të Legjislaturës së 8, data 30.12.2025, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës i datës 08.12.2025;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga Vazhdimi i mbledhjes Inauguruese të Kuvendit të Komunës të datës 08.12.2025, mbajtur me 18.12.2025;
3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;

5. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026;
6. Kërkesë e DSHPE për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;
7. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;
8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat në komunën e Kaçanikut;
9. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të lokaleve që planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 (afatshkurtër 1-15 vite).

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: A ka kush ndonjë vërejtje në Procesverbal? Për ndonjë vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës.

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës të datës 08 dhjetor 2025/ Lënda: 01Nr. 60/01-30744/2025.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga Vazhdimi i mbledhjes Inauguruese të Kuvendit të Komunës të datës 08.12.2025, mbajtur me 18.12.2025;

Kryesuesi i Kuvendit: A ka kush ndonjë vërejtje në Procesverbal? Për ndonjë vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e datës 18.12.2025 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin nga Vazhdimi i mbledhjes Inauguruese të Kuvendit të Komunës të datës 08.12.2025, mbajtur me 18.12.2025/ Lënda: 01Nr. 60/01-30749/2025.

3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Kryesuesi i Kuvendit: Sipas Propozim Vendimit, KPF përfaqësohet me 7 anëtarë si vijon: Partia Demokratike e Kosovës-PDK me 3 anëtarë me kryesuesin e KK sipas funksionit, Lëvizja Vetëvendosje-LVV me 2 anëtarë, Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK

me 1 anëtar, Vizioni për Zhvillim Ekonomik-VZHK me 1 anëtar. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë shkojmë në propozime konkrete, duke filluar nga PDK. Kërkojmë nga subjektet politike, sipas përfaqësimit, ti japin propozimet e veta:

znj. Dardana Tafili Dauti : Nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, për anëtarë të KPF i propozojmë të jenë: 1. Bashkim Krasniqi dhe 2. Lejla Muhaxheri Çaka.

z. Islam Gashi: Nga Lëvizja Vetëvendosje-LVV, për anëtarë të KPF i propozojmë të jenë: 1. Kadrije Lika-Troni dhe 2. Ernesta Krasniqi.

znj. Samedin Rexha: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, për anëtar të KPF e propozojmë të jetë: Ardita Rrahmani.

z. Heset Malsiu: Nga Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut-VZHK, për anëtar të KPF e propozojmë të jetë: Kjani Zeneli.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimet të cilat dolën për anëtarë të KPF, i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan njëzëri. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), në përbërje prej 7 anëtarëve, si vijon:

1. Selajdin Troni	PDK	Kryesues sipas funksionit
2. Bashkim Krasniqi	PDK	anëtar
3. Lejla Muhaxheri Çaka	PDK	anëtar
4. Kadrije Lika Troni	LVV	anëtar
5. Ernesta Krasniqi	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Kjani Zeneli	VZHK	anëtar.

/Lënda: 01 Nr. 060/01-31222/25.

4. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;

Kryesuesi i Kuvendit: Përbërja e Komitetit për Komunitete në komunën tonë është prej 5 anëtarëve, 4 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës, 1 anëtar do të jetë nga OJQ/shoqëria civile. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë shkojmë me propozimet konkrete të përfaqësuesve të KK në këtë komitet.

znj. Dardana Tafili Dauti: Ne si Partia Demokratike e Kosovës-PDK, ia lëmë ulësen për anëtar të Komitetit për Komunitete, Hafize Sallahi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK.

z. Enis Vishi: Nga Lëvizja Vetëvendosje-LVV, për anëtar të Komitetit për Komunitete, e propozojmë të jetë, Islam Gashi.

znj. Ardita Rrahmani: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, e propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete të jetë, Betim Shala.

z. Heset Malsiu: Nga Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut-VZHK, e propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete të jetë, Lejla Luta.

z. Valdrin Dogani: Nga OJQ/Shoqëria civile e propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete, Shemsedin Abazi. z. Abazi ka qenë edhe me herët edhe në KKSB.

znj. Ardita Rrahmani: Parashtroj pyetje pse nuk është e njëjta përbërje në këtë komitet, si në KPF dhe a do të paguhet këtë herë anëtari nga OJQ/shoqëria civile ?

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje është e rregulluar me Udhëzim Administrativ. Anëtari nga OJQ/shoqëria civile, normal se do të paguhet. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozimet për anëtarë të Komitetit për Komunitete të cilat u dhanë, i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat aprovuan njëzëri. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komiteti për Komunitete, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, si vijon:

1. Islam Gashi	LVV	anëtar
2. Betim Shala	LDK	anëtar
3. Lejla Luta	VZHK	anëtar
4. Hafize Sallahi	AAK	anëtar
5. Shemsedin Abazi	OJQ/ Shoqëria civile	anëtar.

Lënda: 01Nr.0 60/01-31223/2025.

Kryesuesi i këtij komiteti zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këtij komiteti.

5. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky komision do të përbëhet nga 7 anëtarë, 6 janë nga KK, 1 anëtar nga Ekzekutivi. Komisioni për hartimin e Planit të punës së KK do të mbajë vetëm një takim. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete për anëtarë të komisionit:

znj. Dardana Tafili Dauti: Nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK e propozojmë për anëtar të komisionit të jetë, Lejla Muhaxheri Çaka.

z. Buletin Guri: Nga Lëvizja Vetëvendosje, e propozojmë për anëtar të komisionit të jetë, Jeton Luma.

znj. Ardita Rrahmani: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK e propozojmë për anëtar të komisionit të jetë, Samedin Rexha.

z. Heset Malsiu: Nga Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut-VZHK, për anëtar të komisionit e propozojmë të jetë, Kjani Zeneli.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është Hafize Sallahi, nga Ekzekutivi i komunës për anëtare të komisionit është Makfîre Malsiu. Komisioni kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit, Selajdin Troni. Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim dhe u aprovuan njëzëri. Prezentë 21. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, në përbërje si vijon:

1. Selajdin Troni	PDK	kryesues
2. Lejla Muhaxheri Çaka	PDK	anëtar
3. Jeton Luma	LVV	anëtar
4. Samedin Rexha	LDK	anëtar
5. Kjani Zeneli	VZHK	anëtar
6. Hafize Sallahi	AAK	anëtar
7. Makfire Malsiu	Zyra e Kryetarit	anëtar.

Lënda: 01Nr. 060/01-31225/25

6. Kërkesë e DSHPE për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën ia jap drejtorit të DSHPE, Arian Teneqja:

z. Arian Teneqja: Pasi përshëndeti të gjithë, shfrytëzoi rastin t'iu uroj marrjen e mandatit, anëtarëve të KK, duke iu dëshiruar punë të mbarë. Ky vendim për shfuqizim të planit, është për një plan ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave, i hartuar nga konsulentët e GIZ me pjesëmarrjen e të gjitha komunave. Pasi plani ka marrë vërejtje nga MMPHI, ky plan duhet të përmirësohet, në mënyrë që të jetë unik për krejt komunat. Për këtë arsye kërkoj të shfuqizohet, pastaj pasi të përmirësojnë komunat tjera, të procedojmë përsëri në KK.

Kryesuesi Kuvendit: Lidhur me këtë pikë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Desha me pyetur drejtorin, për të satën herë është duke ardhur kjo lëndë në KK për shfuqizim? Këtë çështje e kemi pasur edhe në mandatin e kaluar, e kemi shfuqizuar vendimin dhe përsëri është duke na ardhur për shfuqizim, për shkak të gabimeve apo çka kanë gjetur ata të ministrisë. Ne po marrim vendime, ndërkaq të njëjtën kohë po i procedoni në KK për shfuqizim, me çka po biem në kundërshtim me vetën dhe po i shfuqizojmë. Kërkoj nga Kryetari i Komunës që kjo praktikë mos të ndodhë si në mandatin e kaluar. Ne nuk jemi kundër vendimeve, por mos të marrim vendim që nuk i plotësojnë kriteret dhe që janë të jashtëligjshme, e pastaj ti shfuqizojmë.

z. Arian Teneqja: Siç e potencova, ky është një plan ndërkomunal i hartuar nga konsulentët e GIZ dhe pjesëmarrja e komunave të rajonit të Gjilanit dhe Ferizajt. Nuk është vetëm komuna e Kaçanikut hartuese e këtij plani. Në momentin që drafti i hartuar nga grupi punues vjen, ne duhet me proceduar me votim. Nëse ka vërejtje, vërejtjet nuk plotësohen vetëm nga ana jonë, por nga gjithë komunat e rajonit të Gjilanit dhe Ferizajt, dhe mandej të kalon, se ky plan nuk është vetëm i komunës tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Për SHFUQIZIMIN e Vendimit 01 nr.104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për miratimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt/ Lënda: 01Nr. 07-104/ 02-31243/25.

7. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: Këto lista publikohen për 1 vit, në mënyrë që nëse ka ndonjë investitor të jenë të gatshme për me u dhënë në shfrytëzim. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

znj. Ernesta Krasniqi: Kam disa pyetje për listën e veçantë të pronave komunale. A është e përcaktuar periudha kohore dhe qëllimi për çka kanë me u dhënë në shfrytëzim?

Kryesuesi i Kuvendit: Këto prona publikohen në çdo fund vit dhe rrinë të publikuara, që nëse kemi ndonjë kompani apo ndokush tjetër i interesuar me i marrë në shfrytëzim, me ditur se cilat prona epën në shfrytëzim.

z. Qamil Stagova: Së pari iu përshëndes dhe ju uroj mandatin të gjithë anëtarëve të zgjedhur të KK. Në bazë të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, parashihet që të shpallet lista e pronave që duhet të epën në shfrytëzim në vitin vijues. Kjo është edhe arsyeja që e kemi proceduar këtë pikë në këtë mbledhje.

znj. Ernesta Krasniqi: Të neni 13 publikimi i pronave të paluajtshme të komunës, pika 2 thuhet: lista e pronave të paluajtshme të cilat epën në shfrytëzim, duhet të përmbajnë këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës, qëllimni, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Kjo listë nuk i përmban të dhënat e kërkuara, kështu që LVV nuk e përkrahë, përderisa është e jashtëligjshme.

z. Qamil Stagova: Ato të dhëna të kërkuara për pronat komunale, do të jenë kur t'i propozojmë kuvendit me i dhënë në shfrytëzim.

znj. Ernesta Krasniqi: Neni 13 i ligjit e thotë se lista e pronave të paluajtshme të komunës duhet t'i përmbajnë të dhënat e kërkuara. Ligji nuk e thotë që pasi të dalin në ankand publik pronat. Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, duhet të ketë të qartë qëllimin. Unë kam qenë edhe komision vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Në momentin që vijmë ofertat, duhet me pasur afatin kohor për dhënien e tyre në shfrytëzim. Unë mendoj se kompanitë dhe çdo i interesuar tjetër, duhet me pasur paraprakisht të qartë qëllimin dhe periudhën kohore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, se atëherë i planifikojnë edhe ofertat e tyre në mënyrë me të mirë, se publikimi i listës nuk bëhet pa i pasur këto të dhëna.

z. Qamil Stagova: Të dhënat ka me i pasur, se ky KK ka me marrë vendim, kjo është një listë me e gjerë, ndërkaq ne pas një kohe kur të shohim në bazë të kërkesave të qytetarëve apo analizave të komunës vendosim. Fjala vjen, nëse epën pesë prona në shfrytëzim, atëherë i kompletojmë të dhënat për ato pesë prona.

znj. Ernesta Krasniqi: Kjo listë a është e përgjithshme apo e veçantë? Nëse është e veçantë, pse nuk janë përcaktuar të dhënat e kërkuara sipas ligjit?

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj mos të bëni bashkëbisedim.

z. Qamil Stagova: Kjo listë është e veçantë. Firmat konkurrojnë në bazë të kësaj liste, KK e merr edhe një vendim paraprak për pronat të cilat i jep në shfrytëzim.

znj. Ernesta Krasniqi: Të dhënat duhet të jenë edhe kur publikohet kjo listë, se ligji e thotë ashtu.

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Shfrytëzoj rastin t'iu uroj mandatin e ri anëtarëve të KK, shëndet dhe suksese. Sa i përket pyetjes së Ernestës, ai është hapi i dytë që do të merr KK, që me ia krijuar mundësinë firmave serioze. Në hapin e dytë përcaktohet destinimi, se tani nuk mundemi me përcaktuar destinimin për secilën pronë, pastaj i shikojmë ofertuesit se a janë serioz apo jo dhe për veprimtarinë që kërkojnë, tregtare apo zejtare. Në parim e keni mirë, por kështu është përgjigja.

znj. Ernesta Krasniqi: A bënë me ditur në hapin e parë cilat të dhëna kërkohen me ligj, tregoma nenin?

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Ligjin e keni, kështu që mund të shikoni. Është neni 13 paragrafi 2.

znj. Ernesta Krasniqi: Neni 13 e thotë atë që po e themi unë. A e keni lexuar nenin 13 se çka përmban?

Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Nëse ne nuk e kishim proceduar në këtë mbledhje listën e pronave komunale, ia kishim pamundësuar investitorëve për me marrë toka në shfrytëzim për zhvillim ekonomik. Kështu që e kemi proceduar listën, pastaj kur të përcaktohen pronat që dalin nga kjo listë, e kompletojmë me dokumentet e kërkuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ne çdo herë e kemi proceduar listën e pronave që do të jepen në shfrytëzim, pastaj në bazë të ofertueseve, e kemi formuar një komision për pronat që kemi vendosur me i dhënë në shfrytëzim. Vendimet kanë shkuar në MAPL dhe nëse ka pasur ndonjë vërejtje i kemi shfuqizuar apo i kemi harmanizuar.

z. Bashkim Krasniqi: Fillimisht iu uroj për mandatin anëtarëve të KK. Sa i përket pronave komunale si në listë, ne nuk do të thotë se me votimin e kësaj liste, do t'i japim në shfrytëzim dikujt këto prona. Anëtarët që kanë qenë me herët këtu, e dinë që formohet një komision prej KK, i cili komision i shqyrton ofertat që shpallën me u dhënë në shfrytëzim, dhe për çdo pronë që epët në shfrytëzim, përsëri ne kemi me vendosur. Ne nuk mundemi mos me vendosur për listën, që me ia mohuar dikujt të drejtën për një pronë, se ekziston mundësia me pasur oferta serioze për atë pronë. Ne kemi me votuar këtë listë, dhe nëse vjen ndonjë ofertues serioz, atëherë zhvillohet procedura e mëtejme dhe përsëri për atë pronë lënda vjen në KK dhe ne vendosim. Unë mendoj se kjo listë duhet me u votuar, se është në të mirë të komunës tonë.

znj. Ernesta Krasniqi: Në bazë të nenin 13 paragrafi 1 dhe 2, shikoni se a i keni të dhënat e kërkuara që me u votua kjo listë. Pika 1 e nenit 13 thotë se komuna duhet të publikoj listën e përgjithshme dhe listën e veçantë të pronave komunale që planifikohen me u dhënë në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin ekonomik dhe zhvillimin ekonomik të komunës. Lista e dytë i kërkon këto të dhëna: qëllimin, destinimin, periudhën kohore. Ju po thoni që është e ligjshme, nëse është ashtu, atëherë ku e keni të dhënat si nëparagrafin 2 të nenit 13?

Kryetari i Komunës: Edhe në mandatin e kaluar kur kemi shqyrtuar çështje të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, gjithmonë keni thënë se ka shkelje ligjore.

znj. Ernesta Krasniqi: Gjithmonë a, a ma nuk është e ligjshme.

Kryetari i Komunës: Nëse vazhdon Ernesta me këtë qasje, unë nuk të përgjigjem fare.

znj. Ernesta Krasniqi: Mos u përgjigj.

Kryetari i Komunës: Kur të diskutoj unë, dua me më dëgjuar, ndërkaq a e kam mirë apo keq, e vlerësojnë të tjerët. Përndryshe, çdo vendim që miratohet në KK, shkon në MAPL, nëse është e jashtëligjshme, e kthejnë, kështu që mos u merakos shumë për këtë punë.

znj. Ernesta Krasniqi: Sipas juve, a është i ligjshëm ky Propozim Vendim, a i ka paragrafin 1 dhe 2 të nenit 13?

Kryetari i Komunës: Ne mendojmë se është e ligjshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Ernesta, mos të bëjmë bashkëbisedim të lutem.

znj. Kadrije Lika Troni: Të nderuar, jemi këtu me i diskutuar çështjet dhe problemet, e mos me i lënë me i dërguar në MAPL dhe me na u kthyer. Kryetar, qasje jote qysh në ditën e parë për mos me dhënë përgjigje, nuk është e mirë kjo, se ti duhesh me qenë këtu se bashku me neve për punë dhe çështjet që i adresohen KK.

Kryetari i Komunës: Nuk dua të me ndërprejë kur diskutoj.

znj. Kadrije Lika Troni: Edhe ju mos me ndërprejë kur diskutoj. Unë po ju kuptoj juve që po doni me i proceduar pronat në afatin e fundit, por nuk ju keni përmbajtur kritereve që kërkohen. Është dashur ofertuesit me ia lehtësuar punën dhe qasjen kur ai hynë në faqe të komunës dhe i kontrollon pronat se cilat janë, e din për çfarë veprimtarie janë destinuar, për industri apo për cilën veprimtari është dhe ai planifikon për me marrë. Ju ato nuk i keni plotësuar, për atë ne si grup i LVV do të jemi kundër Propozim Vendimit që e keni sjellë për votim.

Kryetari i Komunës: Për qasjen, unë thashë nëse vazhdoni me më ndërprerë kështu, nuk thashë diçka tjetër. E dyta, ju çdo herë keni qenë kundër kur kemi pasur në shqyrtim çështjen e pronave komunale, sidoqoftë vazhdoni kështu.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë. Rezultati i votimit është, 12 votë Për (8-PDK, 3-LDK, 1-AAK), Kundër 6- LVV, Abstenim 3 -VZHK. Prezentë 21. Në bazë të rezultatit të votimit, konstatoj se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 nga lista e përgjithshme e pronave komunale/ Lënda: 01Nr. 060/01-31302/25.

8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat në komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Propozim Vendimi ka ardhur nga Kryetari i Komunës, atëherë ia kaloj fjalën kryetarit. Meqë kryetari ia dha fjalën drejtorit të financave, atëherë fjalën e merr DBF, Valdrin Dogani:

z. Valdrin Dogani: Shfrytëzoj rastin edhe një herë të uroj anëtarëve të KK për mandatin e marrë, uroj KK të merr vetëm vendime të mira. Sot para jush po e paraqes, Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat në komunën e Kaçanikut për nënat lehona rezidente në komunën e Kaçanikut, i propozuar nga Kryetari i Komunës, Sabedin Vishi. Ky vendim e ka një qëllim të qartë që me i dhënë një ndihmë familjes në momentin me të ndjeshëm kur lindë një fëmijë. Edhe kjo shumë nuk i mbulon të gjitha shpenzimet, është një mbështetje konkrete si shenjë e kujdesit të institucionit për ndihmë momentale. Kjo vlerë është e planifikuar edhe në buxhetin e komunës së Kaçanikut për vitin 2026, të kategoria ekonomike subvencione dhe transfere. Kërkojmë nga KK miratimin e këtij vendimi, që këto mjete të zbatohen si politikë komunale. Ky vendim do të ndihmon familjet dhe rritë sigurinë në një moment kyç, për familjen dhe jep mesazh se komuna e prek familjen dhe e përkrahë natalitetin, rritë sigurinë qytetare se buxheti kthehet në shërbim të drejtpërdrejtë për ta. Procedura e zbatimit do të jetë e thjeshtë dhe transparente, është vetëm për nënat lehona rezidente të komunës së Kaçanikut. Kjo është mbështetje e drejtë, me buxhet, e realizuar, andaj kërkoj të mbështetët miratimi i këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Jeton Luma: Fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe qytetarët e komunës, ndërkaq lidhur me pikën që është çështje debati theksoj: Ne si LVV kemi qenë dhe mbetemi gjithmonë në mbështetje të nënave lehona. Kjo mbështetje është dëshmuar në praktikë, si në nivelin qendror dhe në komunat ku qeverisë LVV. Sa i përket Propozim Vendimit për mbështetje të nënave lehona, me vjen mirë që po e ndiqni këtë shembull të komunave tjera ku qeverisë LVV, por duhet me përmendur një fakt që, propozimi për mbështetje të nënave lehona për herë të parë ka ardhur nga grupi i asambelistëve të LVV, konkretisht nga znj. Arta Avdiu Tusha. Për këtë ekzistojnë dëshmi të qarta në procesverbale të mbledhjeve të mbajtura në mandatin e kaluar. Ne si LVV e përkrahim çdo vendim që synon përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, në veçanti të nënave lehona. Megjithatë, konsideroj duhet shqyrtuar mundësia që kjo shumë të rritet në vazhdimësi.

z. Bashkim Krasniqi: Ne si grup i PDK e mbështetim këtë Propozim Vendim, ndoshta është dashur një shumë me e madhe në mbështetje të lehonave, por këto janë mundësitë buxhetore. Sa i përket propozimeve kush i ka dhënë, me vjen mirë që e paska pasur propozime, por ne jemi këtu për me dhënë propozime, me dhënë ide, me diskutuar. Sa i përket komunave tjera, asnjë komunë nuk është shembull, ne si komunë i kemi politikat tona, këtë punë e vlerëson populli, e vlerësojnë banorët.

znj. Ardita Rrahmani: Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, qytetarët dhe ata që po na ndjekin drejtpërdrejtë, uroj anëtarët e zgjedhur për mandatin, uroj secilit shëndet të qojë mandatin deri në fund, mandej sukseset vijnë kur bëhemi të gjithë bashkë. Po me vjen shumë mirë për një Propozim Vendim të tillë, jam shumë e lumtur që jam pjesë e kësaj legjislature të cilën po e votoj dhe jam e bindur se ka me qenë ndër të rrallat vendime, që kemi me pasur unitet në votim, sepse që për katër vite e dimë praktikën e vendimeve. Përgëzime për zonjat, për nënat, fëmijët që do të vijnë në jetë nga 1 janari 2026.

znj. Hafize Sallahu: Përshëndet të gjithë, urime për mandatin të zgjedhurve, edhe pse ju kam uruar dhe përgëzuar, mbi të gjitha po ndihem shumë e gëzuar që po e fillojmë vitin me një vendim shumë të mirëpritur për qytetarët. Prandaj, përgëzime kryetar, uroj që të

vazhdosh gjatë 4 viteve kështu, uroj të gjitha nënat lehona. E di se nuk janë të mjaftueshme, kam qenë 4 vite në ekzekutiv, e di buxhetin e komunës, por është një hap i parë, por i përgëzoj ata të cilët e propozuan për herë të parë, pavarësisht se kush e propozon nga cili subjekt politik, çdo vendim i mirë për qytetarët e komunës, duhet mirëpritur dhe duartrokatur. Andaj shpresoj me këso vendimesh do të vazhdojmë mandatin për 4 vite.

znj. Kadrije Lika Troni: Për vite me radhë ne kemi kërkuar me i mbështetur nënat lehona, ashtu siç e potencoj edhe kolegu im, se paku me një shumë simbolike, por na është thënë se nuk ka buxhet. Jo vetëm njëherë, por disa herë gjatë mandatit, të gjithë me radhë kemi kërkuar të mbështetën nënat lehona se paku me një shumë simbolike. Sot kjo ide që dikujt refuzoj, po pretendohet si vendim i parë i kryetarit. Ne e përkrahim çdo vendim në dobi të nënave, por qytetarët duhet ta dinë të vërtetën. Kjo ka qenë kërkesa jonë e vazhdueshme, ndërkaq gëzohem që sot po bëhet realitet dhe ne do të votojmë Për.

z. Heset Malsiu: Fillimisht iu uroj të gjithë të zgjedhurve mandatin për 4 vite, shëndet e suksese. Ky vendim është i mirë. Ne si Vizion i Zhvillimit të Kaçanikut e kemi propozuar gjatë fushatës zgjedhore mbështetjen e lehonave në shumë 300€. Në komunën e Kaçanikut nuk ka mbi 290 lindje në vit, këtë çështje e kemi kalkuluar mirë, kështu që shuma e përgjithshme për mbështetje të lehonave, nuk kalon mbi 90,000€ për një vit buxhetor. Tani ndoshta nuk ka buxhet, por duke ditur çështjen e inflacionit, mendoj se është mirë të shqyrtohet propozimi për rritjen e shumës buxhetore.

z. Jeton Luma: E përmendi edhe kolegu paraprakisht, duke pasur parasysh faktin se ka një dyndje bukur të madhe të qytetarëve në komuna tjera, për shkak të kushteve ekzistuese jo të mira, kështu që nuk është keq me shqyrtuar edhe një herë çështjen e rritjes së shumës buxhetore, si masë mbështetëse për lehonat.

z. Valdrin Dogani: Kur kemi vendosur për këtë shumë buxhetore, ne jemi bazuar diku, jemi bazuar në të dhënat statistikore që janë këtu në komunë, regjistrin civil të lindjeve, kaq janë mjetet që i kemi në dispozicion për mbështetje të lehonave.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat në komunën e Kaçanikut dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 21. Në sajë të kësaj del konstatimi del së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat në komunën e Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 104/ 02-31324/25.

9. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të lokaleve që planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 (afatshkurtër 1-15 vite):

Kryesuesi i Kuvendit: Para se me hapur diskutimin, fjalën ia jap drejtorit të DUKMM, Qamil Stagova.

z. Qamil Stagova: Për dhënien në shfrytëzim të këtyre lokaleve të komunës së Kaçanikut, kemi ardhur në përfundim se edhe këtu duhet të zbatohet ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe këmbimin e pronës. Dhënia në shfrytëzim e këtyre

lokaleve është afatshkurtër, do të epën me qira. Kjo listë nuk është definitive, është lista e gatshme, e njëjta edhe njëherë do të dal në KK për miratim, që me shkuar pastaj drejtpërdrejtë për dhënien e tyre në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Për këto lokale, a është bërë pranimi teknik i tyre, se po me duket se kemi mungesë të materialit, nuk po e dimë as çka kemi me votua. Pse na mungon neve raporti i komisionit që e ka bërë pranimin teknik të atyre lokaleve? Ne duhet me ditur se cilat kushte janë plotësuar me u dhënë në shfrytëzim këto lokale.

z. Qamil Stagova: Për dhënien në shfrytëzim, kanë me u definuar të gjitha kushtet e dhënies me vendimin tjetër që do të sjellim në KK. Aty kanë me u përcaktuar profesionet me përparësi, krejt kanë me u definuar para dhënies së tyre në shfrytëzim. Nuk është kjo listë që shkon automatikisht me u dhënë pronat në shfrytëzim.

znj. Kadrije Lika Troni: Nëse neve na mungon materiali i pranimit teknik, ne nuk mundemi me votuar diçka që nuk e dimë se a janë plotësuar kushtet. Ne nuk mundemi me miratuar diçka, pa e pa pranimin teknik të atyre objekteve. Unë mendoj se duhet me u kompletuar dokumentacioni i nevojshëm, në mënyrë që me ditur secili anëtar i KK se çka është duke votuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori e dha shpjegimin.

znj. Kadrije Lika Troni: Jo nuk e dha shpjegimin, dokumentacioni nuk është i kompletuar. Nuk është puna veç me votuar diçka, pa e ditur se çka po voton. Nëse është bërë pranimi teknik, ai pranim ekziston në drejtori, dhe unë dua me ditur për atë pranim teknik. Ai dokument mua me konvenon me pasur, në të kundërtën nuk e dimë se çka po votojmë.

z. Qamil Stagova: Është shumë e qartë çështja se çka jemi duke bërë. Ne jemi duke u dhënë këto lokale në vitin 2026 në shfrytëzim, ndërkaq ju nuk jeni duke dashur me i dhënë në shfrytëzim ato lokale.

znj. Kadrije Lika Troni: Jo nuk është ashtu, unë jam duke kërkuar dokumentin e pranimit teknik, përndryshe po i vjen se nuk është bërë pranimi teknik. Mundeni me na dërguar pranimin teknik dhe këtë pikë e shqyrtojmë në mbledhjen vijuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk ka diçka, ne e shtrojmë në votim, ndërkaq drejtorit të DUKMM i mbetet obligim me sjellë pranimin teknik në mbledhjen vijuese.

znj. Ernesta Krasniqi: Dokumentacionin e pranimit teknik, është mirë me na sjellë tani.

z. Heset Malsiu: Edhe për mendimin tim, drejtori nuk ishte shumë i qartë. Kur të vini këtu në KK, duhet me qenë me të përgatitur, për me na bindë se duhet me i votuar çështjet që na adresohen.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtorit i mbetet obligim me i përgatitur dokumentet e kërkuara për këtë pikë, ndërkaq Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 12 votë Për (8-PDK, 3-LDK, 1-AAK), Kundër votë nuk ka, Abstenim, 9 (6-LVV, 3 -VZHK). Prezentë 21. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Listës së veçantë të lokaleve që planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 (afatshkurtër 1-15 vite), objektet të Çarshia e qytetit/ Lënda: 01 Nr. 104/02-31432/25.

Kryesuesi i Kuvendit: Për fund, kërkoj të përcaktohem për shefat e grupeve të subjekteve politike të përfaqësuara në KK;

znj. Dardana Tafili Dauti : Nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Shef i grupit është caktuar, Bashkim Krasniqi.

znj. Ernesta Krasniqi: Nga Lëvizja Vetëvendosje- LVV, Shef i grupit është caktuar, Kadrije Lika Troni.

z. Betim Shala: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, Shef i grupit është caktuar, Ardita Rrahmani.

z. Kijani Zeneli : Nga Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut- VZHK , Shef i grupit është caktuar, Haset Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit: Në emër të Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK, fjalën në KK e merr Hafize Sallahi.

znj. Kadrije Lika Troni: Meqë u njoftuam me shefat e grupeve të përfaqësuar në KK, kryetarit i mbetet obligim me na njoftuar për Ekzekutivin e komunës, sepse unë po e shoh se këtu ka drejtorë në detyrë.

Kryetari i Komunës -Sabedin Vishi: Faleminderit për pyetjen Kadrije. Me 05 janar 2026 e kompletojmë ekzekutivin dhe e bëjmë publik njoftimin. Emërimi i anëtarëve të Ekzekutivit të Komunës është e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Komunës.

Kijani Zeneli: Sot është një ditë veçantë për veteranët e luftës, është Dita e Veteranëve të luftës së UÇK. Është dashur që në fillim të mbledhjes, Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës me uruar për Ditën e Veteranëve, por po duhet unë me iu uruar. Unë e shfrytëzoj rastin që të gjithë veteranët e luftës së UÇK-së, t' iu uroj Ditën e Veteranit.

Kryesuesi i Kuvendit: Shumë faleminderit Kijani. Edhe unë i uroj të gjithë veteranëve të luftës së UÇK, Ditën e Veteranëve. I falënderoj të gjithë veteranët e luftës për kontributin e tyre të dhënë si në luftë, rindërtim të shtetit, iu uroj të gjitha të mirat, shëndet, nder e respekt për të gjithë Veteranët e luftës së UÇK-së.

Në fund, Kryesuesi i Kuvendit i njoftoj anëtarët e KK se Laptopët kanë ardhur, e nënshkruani listën të Zyra e IT- të zyrtari Bejtulla Dalloshi, secili nga ju dhe e merrni laptopin.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 11:47. Deri në fund të mbledhjes ishin 21 anëtarët e KK- të gjithë.

Pas mbledhjes, Kryesuesi i Kuvendit, i ftoj anëtarët e KK dhe Ekzekutivin e Komunës për një drekë pune të "Liburna".

Procesmbajtës
Makfite Malsiu

Makfite Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 12 Tetorit 2025);

Në mbledhjen e I (parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës,
(Legjislatura e 8 e KK), mbajtur me 30 Dhjetor 2025:

1. Selajdin Troni.....,
2. Blerim Koxha.....,
3. Xhelal Ceka,
4. Xhelal Dema,
5. Bashkim Krasniqi,.....,
6. Lejla Muhaxheri Çaka,
7. Dardana Tafili Dauti,
8. Shqipe Murseli,
9. Enis Vishi.....,
10. Kadrije Lika Troni.....,
11. Ernesta Krasniqi,
12. Islam Gashi,
13. Buletin Guri,
14. Jeton Luma,
15. Betim Shala,
16. Samedin Rexha,.....,
17. Ardita Rrahmani,
18. Heset Malsiu,
19. Kijani Zeneli,
20. Lejla Luta,
21. Hafize Sallahi,.....,